



Ballina → Arte → ExpressBook



(Foto: Fisnik Dobreci)

Shkrimtarja që gjurmon rrënjët

Shkrimtarja e njohur austriake Barbara Frischmuth flet për vizitën e saj në Kosovë, për krijimtarinë e saj dhe për obsesionin e saj për të hulumtuar rrënjët e kulturave të ndryshme.

Nga Artan Behrami më 28.09.2009 në ora 8:57

Barbara Frischmuth është njëra nga shkrimtaret më të famshme në Austri. Ajo ka botuar mbi 20 libra, prej tyre shumë romane, tregime për fëmijë etj. Izolimi dhe integrimi, rrënjët e popujve dhe të kulturave të tyre përbëjnë temat që trajton në veprat e saj. Ajo është e bindur se rrënjët dhe kulturat e ndryshme të popujve nuk janë pengesë për bashkëjetesë, por ngjyrosjet politike dhe fetare. Në Kosovë ka ardhur për të përruruar rihapjen e Bibliotekës Austriake në Prishtinë, por edhe për të kuptuar për së afërmi rrënjët e kosovarëve. Gjatë viteve 60-ta kishte menduar të mësonte gjuhën shqipe. Thotë se ka lexuar librat e Ismail Kadaresë, të cilin e ka mik të mirë dhe të Rexhep Qosjes. Shkrimtarja austriake, Barbara Frischmuth flet për Express.

Express: Zonja Frischmuth, ju keni ardhur para dy ditëve në Kosovë, cila është përshtypja e parë për Kosovën? Keni pas rastin të vizitoni ndonjë qytet?

Barbara Frischmuth: Unë kam udhëtuar përgjatë vendit, kemi filluar në Mitrovicë, kemi vazhduar në Pejë, në Grykë të Rugovës, kemi vazhduar në Deçan dhe Prizren – në fund kemi përfunduar në kampin e Ushtrisë Austriake në Suharekë. Sot kemi qenë tek varri i Rugovës, tek varri i Sulltan Muratit – gjithçka që mund të vizitohet e kemi vizituar.

Express: Çfarë do t'ju mbetet në kujtesë nga qëndrimi i juaj në Kosovë?

Barbara Frischmuth: Në njërin anë objektet kulturore dhe në anën tjetër një kombinim i shkatërrimit dhe zhvillimit që mund ta vëshesh kudo. Ato rrugë që po ndërtohen, pra shihet që ka ndryshuar shumë çka në dhjetë vjetët e fundit. Por, unë jam e interesuar edhe në rrënjët e kosovarëve. Unë njoh shumë mirë botën myslimane, ngase kam studiuar turqishten, por njoh edhe rrënjët e vjetra të Austrisë dhe për mua këto dyja janë prezente edhe në Kosovë. Pra kjo është shumë interesante që ka kaq shumë gjurmë, nga epoka të ndryshme.

Express: A mund të tërhiqen paralele mes Turqisë dhe Kosovës?

Barbara Frischmuth: Në njërin anë ka shumë gjurmë që pasqyrojnë mënyrën e të jetuarit nga koha otomane, kur shpesh them "a këtë e njoh, e kam pa diku", por edhe fjalët. Në anën tjetër ka gjëra tjera që më ngjajnë në Austrinë e vjetër, që e njoh nga Evropa Perëndimore dhe Jugore. Prandaj është një kombinim interesant. Por, ke përshtypjen se je në një shtet evropian, e jo në një shtet mysliman, siç është Turqia. Më shumë nuk guxoj të them, sepse përshtypjet e mia mund të jenë të gabuara.

Express: Gjatë përrurimit të rihapjes së Bibliotekës Austriake në Prishtinë ju keni lexuar diçka nga librat e juaj. Nga cili libër keni lexuar?

Barbara Frischmuth: Libri quhet "Zbërthimi" dhe ka të bëjë me gjurmët e kulturave të ndryshme dhe unë mendoj që këto gjurmë mund të gjenden në tërë Evropën. Unë besoj që kulturat dominuese për një kohë të gjatë, siç është ajo katolike apo myslimane, janë përzier më mirë se që vërehet në shikim të parë. Kultura gjithmonë ka trazuar rrugën e vet dhe këtë e them me bindje të plotë, që një kulturë e vetëkënaqur nuk mund të mbetet kulturë. Kulturat jetojnë nga ndikimet nga jashtë, përpunimi, fërkimet, stimulimi i ndërsjellë është shumë i rëndësishëm për të mbijetuar një kulturë.

Express: Sa është e rëndësishme kjo bibliotekë për të shkëmbyer informacione mbi kulturat tjera?

Barbara Frischmuth: Unë mendoj se literatura është një mjet shumë i mirë, për të kuptuar botën. Dhe unë mendoj që në kohërat ku ekonomia nuk është materializuar tërësisht, në këto raste, literatura është mjeti më i lehtë për të vështruar botën, sepse për literaturë ju duhet vetëm një libër dhe një ulëse dhe pak dritë.

Express: Gjatë leximit në bibliotekë ju keni thënë që keni pas ndërmend të mësoni shqipen. Pse keni dëshiruar të mësoni shqipen dhe si rastisi puna që nuk e mësuat?

Barbara Frischmuth: Ka qenë kështu: unë kam studiuar turqishten, jam specializuar për dervishët, bektashinjtë dhe alevitët. Profesori i atëhershëm dëshironte të më dërgonte në Shqipëri. Unë e kisha për detyrë që të hulumtoj mësimet e fshehta të bektashinjve, që në atë kohë konsiderohej i fshehtë. Ndërsa, profesori tjetër më thoshte 'ju lutëm më mirë mos shkoni, sepse unë tërë jetën nuk kam mundur të marr asnjë informacion, dhe ty si grua e re që je nuk do ta thonë hiq se hiq'. Po të isha shkuar në Shqipëri, do ta kisha mësuar edhe shqipen, por krahas kësaj kisha mësuar turqisht, hungarisht, arabisht dhe ishte tepër. Por, edhe shqipja do të ishte një opsion i mirë, por nuk kam shkuar.

Express: Ju keni shkruar shumë romane, tregime për fëmijë etj. Në çfarë jeni të fokusuar më shumë?

Barbara Frischmuth: Proza letrare është mediumi im burimor, gjithmonë më ka interesuar segregacioni (izolimi) dhe integrimi kulturave të ndryshme. Gjithmonë kam pas dëshirë të studioj gjuhë orientale. Kjo është reflektuar edhe në literaturën time. Kësaj i shtohet edhe tema e integritetit, nga punëtorët, nga migracioni, që kanë ardhur në Evropë. Temë tjetër është edhe emancipimi, jo vetëm i grave, por emancipimi i njerëzve. Kjo më ka interesuar gjithmonë.

Express: Sa të ndryshme janë këto kultura orientale me ato evropiane?

Barbara Frischmuth: Nuk mendoj që janë të ndryshme. Kultura myslimane është e shtrirë deri në Evropë. Dhe ka një bashkëjetesë prej qindra viteve. Pikërisht në librin tim "Dekodimi" jam munduar të prek këtë temë, qysh idetë fetare, p.sh besëtytnitë janë përhapur shumë shpejt në të tri fetet, tek krishterët, myslimanët dhe hebrejtë. Prandaj mendoj se ajo "krejt ndryshe" diferenca në realitet është një konstrukt, që nganjëherë bëhet për arsye politike. Nëse shikojmë historinë, ka pas një bashkëjetesë të mirë. Ka pas periudha ku ligjet fetare nuk janë implementuar me rregulla strikte. Kur kam qenë herën e parë në Egjipt, nuk ka pas gra me shami në kokë, tash kemi me shami. Këto janë gjëra që zbulohen për qëllime politike, por me gjurmët kulturore nuk ka të bëjë asgjë.

Express: Pra ju besoni në një bashkëjetesë?

Barbara Frischmuth: Unë them se kjo është e mundur, por paraprakisht duhet siguruar këto mundësi. Arsyeja pse më së shumti e kritikoj politikën është se në mënyrë cinike nxehë probleme të caktuara, për të fituar fuqi.

Express: Por këtë po e bëjnë edhe fetë apo jo?

Barbara Frischmuth: Po! Nganjëherë edhe fetë e bëjnë këtë, sepse ato përdorën nga njerëzit. Unë njoh vijat e argumentimeve. Ka shumë fundamentalistë islamikë, por edhe fundamentalistë katolikë që kritikojnë njëri-tjetrin. Myslimanët thonë alkooli është problemi i juaj, fëmijët dhe të vjetrit ju i dorëzoni në shtëpi të pleqve. Katolikët thonë ju jetoni në familje patriarkale, ju përdorni dhunë ndaj grave. Pra dihen këto argumentime dhe fatkeqësisht njerëzit gjithmonë mashtrohen, sepse është një argumentim shumë i thjeshtë!

Express: Në këto tri ditë, ju ka inspiruar diçka, për të cilin kishit mundur të shkruani diçka?

Barbara Frischmuth: Është një kohë shumë e shkurtër. Më mirë i referohem autorëve shqiptarë. Unë njoh personalisht Ismail Kadarenë. Para një viti e gjysmë kemi qenë së bashku në një organizim, unë e kam moderuar atë, kam biseduar me të. Unë kam lexuar edhe nga Rexhep Qosja. Për mua është me rëndësi të lexoj përkthime nga gjuha shqipe, nga literatura shqipe, sepse është metoda e mirë për t'u ballafaquar me një shtet tjetër.